



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA ROSKOVEC**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Roskovec, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2021

**NJOFTIM**

**Lënda :** Njoftim për mbajtjen e mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Roskovec

**Drejtuar :** z/znj \_\_\_\_\_

*-Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Neni 17,53 i tij, njoftoheni se ditën e Enjte datë 29.04.2021, ora 12<sup>00</sup>, në sallën e Këshillit , organizohet mbledhja e Këshillit Bashkiak mbledhje e radhës. Lutemi të paraqiteni në mbledhje me maska. Rendi i ditës:*

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Mars dhe Prill 2021.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Për dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Mars 2021.
5. Për mbarimin para kohe të mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Roskovec.
6. Për anulim të Vendimit Nr.17 datë 31.03.2021 "Për miratimin e rregullores për ngritjen, funksionimin dhe ndërveprimin e Strukturave Komunitare në Bashkinë Roskovec" dhe anulim të Vendimit Nr.18 datë 31.03.2021 "Për disa shtesa në Vendimin Nr.88 datë 22.11.2020 "Për miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2021".
7. Për miratimin e rregullores "Për ngritjen, funksionimin dhe ndërveprimin e Strukturave Komunitare në Bashkinë Roskovec".
8. Për disa shtesa në Vendimin Nr.88 datë 22.11.2020 "Për miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2021".
9. Për miratimin dhe transferim fondesh në Buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2021.
10. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

*Shënim: Materiali i projekt-vendimit të pikës Nr.7 të rendit të ditës është i njëjtë me materjalin që ju është shpërndarë një mbledhje më parë.*

**K R Y E T A R**  
**Kadri HYSKA**